

VENDIM
Nr.58, datë 23.1.2003

PËR TRAJTIMIN ME STREHIM TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.7496, datë 3.7.1991, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, ushtarakë të Forcave të Armatosura, që trajtohen me kredi për strehim, janë oficerë aktivë të Forcave të Armatosura.

2. Gjatë kohës që ushtarakët e mësipërm janë pa banesë ose kanë nevojë për shtesë sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti.

3. Trajtimi me strehim bëhet nëpërmjet sistemit të kredive, me fondet që siguron Ministria e Mbrojtjes, nga të ardhurat e veta, të depozituara në llogari të veçantë, pranë Bankës së Kursimeve. Në këtë llogari të derdhen edhe arkëtimet nga vjeljet e kredisë.

4. Lista e ushtarakëve, për marrjen e kredive sipas pikës 1 të këtij vendimi, propozohet nga Ministri i Mbrojtjes dhe miratohet nga Kryeministri.

5. Kredia jepet në vlerë deri në 5 milionë lekë, me interes 3 për qind dhe afat kthimi deri në 25 vjet për ushtarakët që janë të pastrehë dhe deri në 2.5 milionë lekë, me interes 3 për qind, e afat kthimi deri në 15 vjet, për ata që kërkojnë shtesë për sipërfaqe banimi.

6. Kredimarrësit paraqesin pranë Bankës së Kursimeve këto dokumente:

I. Ata që janë të pastrehë:

- a) Kërkesën personale;
- b) Certifikatën e gjendjes familjare;
- c) dokumentin identifikues;
- ç) dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale;
- d) statusin e të pastrehëve nga organet e pushtetit vendor;
- d) Statusin e të pastrehëve nga organet e pushtetit vendor;
- dh) Aktin e blerjes së banesës, vlerësimi i së cilës është bërë nga ekspertë të licencuar.

II. Për ata që kërkojnë shtesë sipërfaqeje banimi:

- a) Kërkesën personale;
- b) Certifikatën e gjendjes familjare;
- c) Dokumentin identifikues;
- ç) dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale;
- d) Aktin e pronësisë së banesës ekzistuese.

7. Në rastin e ndërtimit të banesës nga vetë ushtaraku, të paraqesë dokumentacionin sipas ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën".

8. Ekzekutimi i kredisë të bëhet, pasi përfituesi i kredisë të vendosë për Bankën e Kursimeve, me barrë hipotekare, banesën e blerë apo të ndërtuar me kredi.

9. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

10. Nuk përfitojnë kredi sipas këtij vendimi ushtarakët që janë trajtuar apo do të trajtohen me kredi sipas vendimit nr.102, datë 5.3.1999, të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano